

HULUMTIM- DIVORCET FORMAL NË MAQEDONI

ARSYET DERI TE DIVORCI FORMAL

Para zyrove të Qendrës për mbrojtje sociale në Tetovë takuam 39 vjeçarin R. S. Ai kishte ardhur për në nisur procedurën për shkurorëzim nga gruaja e tij, me të cilën ka dy fëmijë. Nuk pranoi t'i zbardhet identiteti nga shkaku se nuk dëshiron që "të gjithë të marrin vesh për këtë hap të çuditshëm"

FAMI BAJRAMI

Sociologu Ali Pajaziti, thotë se gjendja e rëndë ekonomiko-sociale në Maqedoni, papunësia dhe varfëria në rritje, bën që shumë shqiptarë të marrin kurorë dhe të kërkojnë një nuse nga shtetet e Bashkimit Evropian (BE) me të cilën do të vinin kurorë dhe do të regullonin letrat e punës në ato vende evropiane.

"Natyrish se gjendja e rëndë socio-ekonomike ndikon që njerëzi të marrin vendime kaq kruciale siç është 'divorci formal', ose i letrave për të emigruar gjoja përkohësisht në ndonjë vend evropian ose perëndimor me qëllim të 'përmirësimit të gjendjes' sociale. Për njerëzit kafshata e gojës është kusht i domosdoshëm i jetesës, por ama vendimi për të braktisur komunitetin e gjerë (shoqërinë amë) dhe atë të ngushtë (familjen) nuk do të duhej të ishin vendime kaq të përhapura dhe të lehta, sepse nderi individual dhe ai familjar janë komponentë shumë të rëndësishëm në kulturën tonë shqiptare që nuk shiten për asnjë para", thotë Pajaziti.

Kontratë e imponuar

"Mendoj se me këtë vendim nuk janë të kënaqur as pala që ofron shërbim e as ajo që merr shërbimin (shqiptari), e më së paku femra e martuar shqiptare, e cila lihet në mëshirë të shtihës, pra të plotësorjës zbrazëtitat e burrit ikanak që fiton për familjen, e në fakt paguan 'tagrën', jolegjitime partneres së tij që i mundëson atij të përmirësojë statusin ekonomik dhe që e mban atë të varur në mënyrë permanente, që e kushtë-



zon me dëbime për çdo moment. Kjo është fotografia e përgjithshme, që s'do të thotë që s'ka përjashtime. Empirikja e shqiptarëve flet për një tablo të këfillë. Dhe një gjë: flisni për marrëveshje. Kjo marrëveshje është kontratë e imponuar, të cilën në mënyra shumë perfide pala mashkullore ia imponon asaj femërore shqiptare. Pra, s'mund të flitet për marrëveshje, por për njëfarë marramendjeje fjalësore-diskursive, pasojat e së cilës vërehen tek më vonë", shton më tej ai.

Madje, sipas tij, klima e përgjithshme pesimiste e bën të veten dhe se "çdo ditë e më shumë njerëzit bombardohen me pashpresinë e së ardhmes, me një defetizëm të rrjetëzuar që bën që të filloni të dyshoni nëse po u lëkundet dhe nën këmbë". Ai pohon se sipas Gallup Balkan Monitor 46 për qind, e qytetarëve të këtij vendi mbeten të pakënaqur me kualitetin e jetesës së tyre dhe kjo ka impaktet e veta, ndër të cilat është edhe mobiliteti social horizontal, pra lëvizja ose shpërngulja prej një vendi në tjetrin, kërkimi i jetës më të mirë (!).

"Por në këtë drejtim ndikon edhe ëndrra e quajtur Perëndim, ku fitimi më nuk është si dikur, natyrish më i mirë se këtu por krahasuar me të kaluarën, më tepër përkufizohet si hapësirë për jetesë më të mirë sesa për fitim dhe kursimi për investime në atdhe. Rol luan edhe imitimi i verbër, mashtrimi me aparençën e kurtbetqarëve (si makinat, shtëpitë etj.), pa

menduar se njerëzit me dekada të tëra kanë investuar mundin e tyre, se s'i kanë fituar me një shkop magjik", thotë Pajaziti.

Turbulencat familjare

Sipas Pajazitit, indi familjar po merr një grusht të fortë nga fenomenet e këtilla, nga odiseadat më reperkusione lëkundëse-traumatike.

"Në këtë kohë është rëndë që të mbash perët në duar duke qenë pranë familjes e jo me mijëra kilometra larg. Kështu paraqitet problemi i socializimit të fëmijëve, i turbulencave dhe tragjediave familjare që për një jetë më të mirë humbin shumë gjëra, humbin stabilitetin e tyre dhe shndërrohen në ambiente të hidhëtisë dhe dredhirave. Është shumë interesant fakti se francezët këta baballarë i quajnë peres demisionarë: baballarë në dorëheqje, kurse anglezët 'temporarily - fathers', etër të përkohshëm që për shkak të prokupimeve të shumta profesionale dhe jetike me fëmijët e tyre takohen rrallë, që mashtrojnë fëmijët e tyre duke u blerë lojëra, veshmbathje e sheqerka, që mundohen të përfitojnë dashurinë e tyre me gjëra materiale", thotë sociologu Pajaziti.

"Të gjithë parametrat flasin se kocka është hedhur, bindja për pathyeshmërinë e familjes është thyer dhe me të hapur të shtetur njerëzit inkurajohen për të bërë hapin "drejt pasurimit", pa menduar mirë rreth reperkusioneve dhe përvojës së atyre që veç më kanë shijuar ujërat e bashkëjetesës me nuset

që u paguhet një sasi e majme parash të aktruar nusërinë dhe nënërinë, të cilën shpeshherë as që e shijojnë me kurbetqarët tanë, por takohen me ta vetëm në kohën e pagesës së kësteve ose të totalit. Koha do të tregojë të vërtetën!", thotë sociologu dhe njëherësh profesori në UEJL, Ali Pajaziti.

Para zyrove të Qendrës për mbrojtje sociale në Tetovë takuam 39 vjeçarin R. S. Ai kishte ardhur për në nisur procedurën për shkurorëzim nga gruaja e tij, me të cilën ka dy fëmijë. Nuk pranoi t'i zbardhet identiteti nga shkaku se nuk dëshiron që "të gjithë të marrin vesh për këtë hap të çuditshëm".

"Nuk kam rrugëdalje tjetër. Këtu kam punuar me një grup muratorësh dhe kam mbajtur familjen. Por, tani fëmijët i kam në shkollë të mesme dhe pas 2-3 vjetësh do t'i regjistroj në ndonjë fakultet. Do duhet të harxhoj më shumë para për t'i shkolluar. Nuk dua të punoj në punën time...", thotë ai, teksa vështron derën e zyrës ku pret të futet për të kompletuar dokumentacionin për ndarje. Ai rëfen se për një hap të këfillë ka marrë pëlqimin edhe nga gruaja edhe nga fëmijët.

"Këtë nuk e bëj nga qejfi, prandaj u konsultova me familjen. Nëse pas katër viteve i marr dokumentet atëherë do t'i tërheq gruan dhe fëmijët atje. Do t'ua mundësoj të mbarojnë fakultet në ndonjë vend evropian. Tani për tani këtu nuk shkojnë punët kah e mira", rëfethet Rasimi.

Nusen ja ka gjetur djali axhës në Gjermani. Ai punon atje një kohë të gjatë dhe në të njëjtën rrugë ka marrë dokumentet. Tani atje e ka familjen, pasi dy vitë më parë është divorcuar nga gjermanja.

"Ajo me të cilën do të kurorë është nga Gjermania Lindore. Djali i axhës është marrë vesh që t'a paguajmë nga 5 mijë euro në vit derisa t'i regulloj dokumentet. Nuk e di sa do kem sukses", nënvizon R.S. (Fund)

(Kjo storje hulamtuese është përkratur nga Asociacioni danez për gazetari hulamtuese SCOOP, që vepron edhe në Maqedoni)



donisë për mbulimin universal dhe ruajtjen e shëndetit të qytetarëve", theksoi Osmani. Ai shtoi se

ndryshimet e ligjeve do të mundësojë edhe ndryshimin e programeve në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, me çka këtë kategori të qytetarëve Ministria, gjegjësisht Qeveria, përmes Buxhetit do t'i sigurojë në Fondin për Sigurim Shëndetësor dhe ata do t'i fitojnë shërbimet si edhe personat të cilët janë të punësuar dhe paguajnë sigurim shëndetësor. (R.F.)

FILLON PUNËN SIMPOZIUMI DY DITORË

Sfidat e arsimit shqip

Komuna e Çairit të mërkurën do të jenë nikoqire e dhjetëra profesorëve universitar, pedagogëve arsimtarë e veteranë të arsimit shqip në Maqedoni, të cilën do të mbildhen me qëllim 122 vjetorit të themelimit të shkollës së parë shqipe, më 1887 në Korçë, e që në kalendarin e festave ka hyre si Dita e mësuesit. Qëllimi i takimit do të jetë mbajtja e Simpoziumit "Sfidat e arsimit në Maqedoni", e cila është organizuar nga Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë "Naim Frashëri" dhe Departamentit të çështjeve arsimore në Komunë e Çairit. Rreth 20 kumtesa, nga profesorë të dy universiteteve në Tetovë dhe nga Fakulteti Pedagogjik dhe Fakulteti Filologjik i Shkupit do të lexohen gjatë dy ditëve të ardhshme. "Mungesa 70 vjeçare e institucioneve të arsimit shqip në Maqedoni ka qenë evidente dhe do kohë të përmirësohet. Shumë pak është bërë, ndaj arsimit shqiptar në Maqedoni aktualisht dhe me të drejtë duhet ti kushtohet më tepër vëmendje dhe investime kapitale, arsyetojnë organizatorët mbajtjen e simpoziumit "Sfidat e arsimit shqip në Maqedoni".

pjesëmarrje kanë konfirmuar edhe përfaqësues të Ministrisë dhe të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, kurse në hapjen solemne të Simpoziumit do të jenë edhe personalitete të jetës publike, si kryetarë komunash, deputete dhe përfaqësues të MASH-it. Sipas programit, të partismit do ti përshëndetën kryetari i Komunës së çairit, Izet Mexhiti dhe udhëheqësi i departamentit të arsimit, Shefqet Zekolli, të cilët edhe kanë siguruar mbështetjen financiare për mbajtjen e këtij aktiviteti shkencor. Në Simpoziumin "Sfidat e arsimit në Maqedoni" do të marri pjesë edhe përfaqësues të sektorëve arsimor të gjitha komunave, të cilat udhëhiqen nga shqiptarët, kurse, në cilësinë e mysafirëve pritë të marrin pjesë edhe studiues nga Kosova, mesin e të cilëve edhe Ramush Lekaj, njohës i mirë i çështjeve arsimore. Në fund të punimeve dy ditore të Simpoziumit do të nxirret edhe një deklaratë e përbashkët e cila do t'ju dërgohet të gjitha subjekteve relevante, për ta marrë si bazë të angazhimeve të veta. (D.D.)

Elmi Jusufi doktoron në FSHMN

Elmi Jusufi nga Shkupi është shqiptari i parë në Maqedoni i cili ka doktoruar në lëmin e Fiziologjisë së bimëve. Më 27 shkurt ai me sukses ka mbrojtur temën e doktoraturës në Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore në Shkup. Ai është i lindur në fshatin Likovë, kurse aktualisht është i punësuar në Institutin e blegtorisë në Shkup.

NDRYSHIME TË REJA NË LIGJIN PËR SIGURIM SHËNDETËSORË

Shërbime shëndetësore për të gjitha kategoritë

Personat të cilët nuk janë të punësuar, të cilët nuk kanë pasuri dhe të cilët nuk janë evidentuar në Agjencinë për punësim. Persona të cilët nuk janë shfrytëzues të ndihmës në para, persona të moshës mbi 64-vjeçe të cilët nuk janë pranuar të pensioneve, persona të cilët vuajnë prej sëmundjeve specifike infektuese, ndërsa nuk kanë sigurim shëndetësor, si dhe rastet tjera sociale. Të gjithë këto kategori të qytetarëve të Maqedonisë që deri më tani kanë qenë të marginalizuar nga aspekti shëndetësor me ndryshimet e Ligjit për sigurim shëndetësor dhe Ligjit për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social në ligje, për herë të

parë të gjithë qytetarëve shtetas të Republikës së Maqedonisë u sigurohet sigurim shëndetësor me pako të plotë të shërbimeve shëndetësore.

Sipas arsyetimit të dhënë në Qeveri, bëhet fjalë për disa dhjetëra mijëra qytetarë, kryesisht grupe të marginalizuara të cilat nuk janë të siguruara sipas asnjë baze, ndërsa shfrytëzojnë mbrojtje shëndetësore përmes programeve nacionale parandaluese të Ministrisë së Shëndetësisë ose fare nuk shfrytëzojnë.

Me këtë në masë të madhe do të përmirësohet arritshmëria universale gjatë shfrytëzimit të mbrojtjes shëndetësore me përfshirjen e personave pa vend-

banim të përhershëm, personave të moshuar, personave të pastrehë dhe grupeve tjera të ndjeshme. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, me këtë masë të gjithë qytetarët do të kenë të drejtë të zgjedhjes së mjekut amë, do të zvogëlohet niveli i udhëtimit drejt niveleve më të larta të mbrojtjes shëndetësore.

Ministri i Shëndetësisë Bujar Osmani sqaroi se me këtë dhjetëra mijëra qytetarë do ta fitojnë pakon themelore, gjegjësisht fitojnë mjekë amë, të drejtë të recetës, të drejtë të shërimin në botën e jashtme dhe të drejtën e kontrolleve dhe mbrojtjes parandaluese.

"Me këtë përmbushet edhe parimi i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë për të gjithë qytetarët të kësaj Repub-